



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
ADMINISTRATORI

Nr. 1224 Prot.

Tiranë, më 29 05 /2024

NJOFTIM
PËR APLIKIM PËR EKSPERT TË JASHTËM INXHINIER NDËRTIMI
(angazhim me kontratë shërbimi)

Universiteti i Sporteve të Tiranës, në zbatim të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në kuadër të projektit “Rikonstruksion i sistemit të kondicionimit të bibliotekës dhe godinës 4–katëshe” të Autoritetit Kontraktor, Universiteti i Sporteve të Tiranës, për të qenë pjesë e Grupit të Punës, kërkon 1 (një) Inxhinjer të fushës së Inxhinjerisë së Ndërtimit si ekspert i jashtëm (të angazhuar me kontratë shërbimi).

Eksperti duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të ketë përfunduar studimet universitare ose pasuniversitare sipas fushës së kërkuar, (Inxhinier Ndërtimi).
2. Të ketë eksperiencë pune mbi 10 (dhjetë) vite.
3. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë brenda datës 02.05.2024, në zyrën e Protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për aplikim;
- Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
- Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit).
- Kopje e noterizuar e licencës në fushën e Inxhinjerisë së Ndërtimit.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
- Vetëdeklarim mbi parandalimin e konfliktit të interesit.

Mënyra e vlerësimit: Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje.

ADMINISTRATORI
Haxhirëte Sulaj

